

LINDITA DINOSHA

ZBATIMI I STANDARDIT GJUHËSOR NË SHKOLLAT FILLORE SHQIPE NË MAL TË ZI

HYRJE

Për shumicën e fëmijëve shqiptarë në Mal të Zi, ballafaqimi me gjuhën standarde ndodh vetëm në moshën shtatë vjeçare, kur shumica prej tyre e fillojnë shkollën. Kjo, si mungesë e kopshteve për fëmijë (në gjuhën shqipe), por edhe e organizimeve tjera siç është teatri apo ndonjë aktivitet tjetër kulturor ku ata mund të komunikojnë sipas normave të caktuara gjuhësore. Nëse do të kujtojmë teoritë e njohura psikolinguistike të cilat kryesisht thonë që arkitektura e të nxënës të gjuhës formohet deri në moshën shtatë vjeçare, atëherë do t'i kemi më të qarta vështirësitë e tyre në zbatimin e standardit, të cilat vihen re gjatë këtij hulumtimi në një nga shkollat fillore të Malësisë. Arsye tjetër është se varianti gegë me të cilin ata komunikojnë në përditshmërinë e tyre është variant më larg standardit të sotëm, sidomos në aspektin fonetik, por jo vetëm.

Megjithatë, tek disa fëmijë që vijnë nga familje me prindër dhe rreth më të shkolluar do të vëmë re se vështirësitë e lartpërmendura nuk kanë rol dominues, sepse ata kanë shumë më pak gabime gjuhësore në të shkruar dhe arrijnë të zotërojnë mjaft mirë edhe rregullat e shqiptimit në të folur.

Ky punim synon të analizojë arsyet kryesore të mungesës së zbatimit të standardit nga shumica e fëmijëve, duke u nisur nga tekstet shkollore, mënyra e zhvillimit të orës mësimore, komunikimi formal/joformal, rrethanat tjera jashtëshkollore, bilinguizmi etj., por edhe të shikojë mundësitë e zgjidhjes së këtij problemi.

Rol të rëndësishëm në këtë aspekt, do të shohim se kanë edhe mësimdhënësit e këtyre shkollave, ndikimi i të cilëve vihet re te klasat përkatëse, kështu që kjo sfidë mbetet kryesisht e tyre, pa anashkaluar kështu çdo ndihmë tjetër që mund të ndikojë në nxënien dhe zbatimin sa më të mirë të standardit gjuhësor, i cili duhet të jetë një për të gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë ata apo cilindo variant që flasin në jetën e përditshme.

Situata e përgjithshme në shkollat shqipe

Dua ta nis këtë analizë me një konstatim të studiuesit të njohur amerikan Noam Chomsky, i cili thoshte: "...zhvillimi i aftësisë mendore

njerëzore, përcaktohet nga natyra jonë e brendshme biologjike. Tani, në rastin e një aftësie natyrore, siç është gjuha, kjo aftësi thjesht ndodh, në atë mënyrë siç mësohet për të ecur. Me fjalë të tjera, gjuha nuk është realisht diçka që mësohet. Përvetësimi i gjuhës është diçka që ju ndodh, jo diçka që ju bëni. Të mësuarit e një gjuhe është nganjëherë si kalimi i fazës së pubertetit. Ju nuk mësoni ta bëni atë; ju nuk e bëni atë sepse shihni njerëz të tjerë që e bëjnë, thjesht, ju jeni krijuar ta kaloni atë në një periudhë të caktuar”¹.

Studiues të tjerë nuk janë pajtuar me këtë konstatim, por nëse pajtohemi që gjuha është diçka që ndodh sikur ecja, atëherë do ta kemi më të qartë atë që iu ndodh shumicës së fëmijëve shqiptarë në Mal të Zi, rrethanat e të cilëve aty ku rriten dhe jetojnë, janë të ndikuara nga faktorë të shumtë jashtëgjuhësorë, që i largojnë ata nga standardi gjuhësor dhe jo vetëm. Them jo vetëm nga standardi, sepse përveç përkatësisë në një variant të dialektit gegë, i cili është mjaft larg standardit të sotëm, ata janë të ndikuar nga shumë fjalë të gjuhës malazeze të cilat janë trashëguar nëpër breza, por që fatkeqësisht vazhdojnë të shtohen nëpërmjet programeve të ndryshme televizive, komunikimit direkt me fëmijë të tjerë të cilët mund ta kenë gjuhë amtare, fëmijë të cilët kanë njërin prind joshqiptar etj. Ky është problem real, jo varianti gegë. Disa nga fjalët sllave që përdoren nga këta fëmijë, sigurisht duke i dëgjuar nga të rriturit në ambientin që i rrethon, i përmend edhe Anila Omari te “Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe”, duke e cituar edhe studiuesen ruse e cila ka dhënë kontribut të spikatur në fushën e ndikimeve të sllavishtes në gjuhën shqipe, A. V. Desnickaja. Ajo përmend fjalët *mraz*, *grabujë*, *shlivë*, *pojavë*, *vodë*, *kral*, *bashtinë*, *uzdajë*, *ubël* etj., të cilat vazhdojnë të përcillen te gjeneratat e reja edhe sot e kësaj dite. Prandaj, shumica e fëmijëve “çalojnë në ecjen e tyre” gjatë fazës më të rëndësishme jetësore të formimit gjuhësor.

Teoritë e njohura psikolinguistike thonë që arkitektura e të nxënit të gjuhës kryesisht formohet deri në moshën shtatë vjeçare. Kjo është “gjuha që ndodh”, dhe me të cilën jemi të lidhur emocionalisht, me ose pa dashje gjithë jetën tonë. Dhe kur kjo gjuhë dallon me atë që është standard gjuhësor, vështirësitë janë më të mëdha dhe mundësitë po ashtu që kjo të shihet pothuajse si një “gjuhë e dytë”, sepse “vihen në situatën e aktivizimit të mekanizmit gjuhësor si me rastin e mësimin të një gjuhe të

¹ N. Chomsky, *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Botimet Toena, Tiranë, f. 173.

dytë”². Madje, profesor Paçarizi pohon se “...mësimi i gjuhës së huaj është më i lehtë, pasi vetë natyra e gjuhës e përcakton edhe aktivizimin e mekanizmit të caktuar për gjenerimin e trajtave përkatëse dhe për ndërtimin e trajtave paradigmatiche”³.

Për shumicën e fëmijëve shqiptarë në Mal të Zi, ballafaqimi me gjuhën standarde ndodh vetëm në moshën shtatë vjeçare, kur ata e fillojnë shkollën. Kjo ndodh si mungesë e kopshteve për fëmijë (në gjuhën shqipe), por edhe e organizimeve tjera siç është teatri apo ndonjë aktivitet tjetër kulturor ku ata mund të komunikojnë sipas normave të caktuara gjuhësore.

Në vëzhgimin që kam bërë në një nga shkollat fillore në Malësi, kjo del të jetë arsyeja kryesore e ngurrimit, kryesisht për të folur në standard, por edhe e mungesës së njohurive në të shkruar. Shtyrja e theksuar e moshës së ballafaqimit me standardin, doemos do të ketë probleme gjatë tentimit të rikuperimit të “kohës së humbur”.

Ndoshta me të drejtë profesor Rexhep Ismajli thekson se “...ata që kanë lindur në mjedis që në familje flet toskërisht, në shumë aspekte e kanë pasur më lehtë ta zotërojnë shqipen standard, për aq sa ajo mbështetet në toskërishten, dhe me këtë qysh në fillim bëhen më të favorizuar në shumë segmente të jetës”⁴, megjithëse kjo del të jetë relative në disa raste konkrete në këto shkolla, sigurisht te pak nga ata.

Problem tjetër serioz, del të jenë gabimet drejtshkrimore në tekstet shkollore të klasave të ndryshme duke i deformuar kështu njohuritë e tyre të para, të cilat do të ndikojnë jo pak në formimin e tyre gjuhësor të mëvonshëm.

Konkretisht, në klasën e gjashtë, vetëm një numër i vogël i nxënësve është në gjendje të dallojë gabimet drejtshkrimore që përmbajnë tekstet. Pas komunikimit që bëjmë me të gjithë, del në pah se ky grup i vogël nxënësish që deri diku i dallon më shpejt gabimet, edhe shkruajnë më drejt, por edhe shqiptimin e kanë më të saktë fonetikisht. Nga njohja me ta, kuptojmë se janë fëmijë, prindërit e të cilëve janë të shkolluar dhe sigurisht kanë një komunikim dhe kujdes tjetër për formimin gjuhësor të fëmijëve.

Pjesa tjetër, sidomos ajo më e painteresuar, rezulton të jenë rritur në një ambient familjar më të varfër gjuhësisht. Dhe këta fëmijë, përveç se nuk kanë interes për t’i pasuruar njohuritë e tyre, shkojnë aq larg sa arrijnë

² Rr. Paçarizi, *Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë*, Kosova Pen Center, Prishtinë 2011, f. 109.

³ Po aty, f. 112.

⁴ R. Ismajli, *Gjuhë standard dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005, f. 27.

të të përqeshin kur ti flet me ta në standard. Pyetjet që më drejtonin ishin: “Pse ti flet si në Shqipni” ose “Elle msuesi flet kshtu”. Gabime të shumta gjuhësore do të vërejmë tek ata, sidomos gjatë shqiptimit ku për shembull lidhëza bashkërenditëse *dhe* shkruhet drejt nga shumica e tyre por shqiptohet *lle* (*edhe-elle*), ose numërori dhjetë shqiptohet *llet*. Ky çalim në shqiptimin e fjalëve të cilat në përgjithësi i shkruajnë drejt, vihet re edhe gjatë recitimit të poezive ku duket se kodi që ua cakton mësimi përmendësh i vargjeve i bën të jenë më të kujdesshëm dhe të gabojnë më pak se në komunikimin e zakonshtëm, por edhe atë të leximit të teksteve të ndryshme. Mes nxënësve që komunikojnë më vështirë vihet re edhe mungesa e vullnetit dhe bashkëpunimit me nxënësit tjerë të klasës të cilët për shumë arsye mund të jenë më të zhvilluar në aspektin gjuhësor. Siç e ka thënë Chomsky “Shpesh është e vështirë të bindësh njerëzit, në një shoqëri fshatare tradicionale, të bashkëpunojë, për shembull, për të ndërtuar një të mirë të përbashkët, ndonëse secili do të përfitonte prej saj”⁵. Megjithëse kjo thënie u përket më shumë prindërve të tyre, sepse shumë prej tyre nuk janë në gjendje të investojnë në këtë drejtim.

Kjo do të thotë, se një ndër faktorët jashtëgjuhësorë të këta fëmijë është edhe ndikimi i prindërve dhe i familjes ku ata rriten. Ndikimi pozitiv vërehet tek ata fëmijë, familjet e të cilëve kanë nivel më të lartë shkollimi, por edhe të atyre që lëvizin më shumë në trojet tjera shqiptare.

Ky është një faktor tjetër i rëndësishëm për zhvillimin dhe këmbimin e njohurive gjuhësore. Siç përmenda më lart që programet televizive malazeze ndikojnë negativisht në përdorimin e fjalëve të tyre pa nevojë gjatë komunikimit në shqip, ashtu kemi edhe realitetin tjetër pozitiv, mundësinë e pasjes së shumë kanaleve televizive shqiptare, ndikimet e të cilave vihen re tek fëmijët që i ndjekin. Ndonjëherë edhe me shtrembërimet përkatëse që mund t’i hasim në programe të ndryshme, por gjithsesi me rezultat më pozitiv krahasuar me asimilimin. Fatmirësisht, zgjedhja e programeve televizive sot është në duart dhe dëshirat e secilit prej nesh, gjë që më herët na ka munguar në Mal të Zi dhe kemi qenë të detyruar në një farë forme të shohim vetëm programe sllave. Megjithatë, televizioni duhet të jetë mjet dytësor për arritjen e qëllimit të zbatimit të standardit, sepse e para nuk është mjet interaktiv dhe e dyta nuk e zëvendëson dot librin dhe literaturën, të cilën fatkeqësisht sikur po e lëmë anash bashkërisht. Faji fillon tek edukata që ju japim fëmijëve dhe pasojat sigurisht vihen re edhe tek ata. Mungesa e leximit dhe leksikut të prindërit

⁵ N. Chomsky, *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Botimet Toena, Tiranë, f. 174.

e sidomos te mësimdhënësit, domosdoshmërisht do të ketë pasoja fatale, jo vetëm në zbatim të standardit gjuhësor, por në njohuritë e përgjithshme dhe nivelin e dijes së fëmijëve tanë.

Për mos ta mbyllur me energji negative, dua të besoj se konteksti pozitiv që na e ka sjellë koha dhe mundësia e lëvizjes në kryeqendrat shqiptare siç janë Tirana dhe Prishtina, por edhe aksesit më i lehtë në literaturë të ndryshme, të jetë dritë e gjelbër për një të ardhme më të ndritur për arsimimin e fëmijëve tanë në përgjithësi dhe për ruajtjen e gjuhës dhe pasurimin e saj në veçanti.

BIBLIOGRAFI

- Chomsky, N., *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Botimet Toena, Tiranë, 2007.
- Gjinari, J. – Shkurta, Gj., *Dialektologji*, SHBLU, Tiranë, 2009.
- Ismajli, R., *Gjuhë standard dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005.
- Omari, A., *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012.
- Paçarizi, Rr., *Shqipja standard në paramentrat psikolinguistikë*, Kosova Pen Center, Prishtinë, 2011.

